

**DREJTORIA E RAJONIT QENDROR TIRANË**  
**FORMULARI I NJOFTIMIT TË FITUESIT**

Data : 16.11.2018

Për: “ NIKA “ shpk, numri i NIPT-it J 76705047 U , me adrese : Lagjja Vasil Shanto ,Bulevardi Skenderbeu , godinë 8 kateshe , kati i I-re, Nr.Pasurie 1014/3, Zona Kadastrale 8593,nr.pasurie 5/587,Shkoder .

Procedura e prokurimit: “*Procedurë e Hapur – Shërbime* ”

Numri i referencës së procedurës/lotit: REF-73352-06-05-2018

Përshkrim i shkurtër i kontratës: Mirëmbajtje me performancë Ura e Brarit - Tunel Qafë Murrizë (Rruga e Arbrit), K/Rr. Nr. 54 (Trau Dajt) - Deg. dj. maja e Dajtit, Deg. dj. maja e Dajtit - St. teleferikut, Deg. dj. maja e Dajtit - Vila Qeveritare, Vila Qeveritare - maja e Dajtit, Tiranë (Fresku) - Surrel, Surrel - Qafë Priskë, Qafë Priskë - deg. dj. Q. Mollë,deg. dj. Q. Mollë - Bizë , Qafë Priskë - Shkallë - Shëngjergj, Uzina Traktorit - Lanabregas, Farkë – Rruga Elbasanit (Sauk) - Komuna e Parisit - Rruga e Kavajës (Loti 1) (104.13 km) (Kontrata 2) , me fond limit 54.520.654 leke ( pa T.V.SH ) , afati i zbatimit te kontrates 24 muaj .

Publikime të mëparshme (*nëse zbatohet*): Buletini i Njoftimeve Publike [11.06.2018] [23]

Kriteret e përzgjedhjes së fituesit: çmimi më i ulët X oferta ekonomikisht më e favorshme □

Njoftojme se, kane qenë pjesëmarrës në procedurë këta ofertues me vlerat përkatëse të ofruara:

1. *Emri i plotë i shoqërisë* NIKA shpk , *numri i NIPT-it* J 76705047 U  
Vlera 34.543.340 ( *tridhjetë e kater milion e peseqind e dyzet e tre mije e treqind e dyzet* ) leke
2. *Emri i plotë i shoqërisë* BOE ALB SHPRESA shpk & I.D.K – KONSTRUKSION shpk ,  
*numri i NIPT-it* J72110003F & K51408016J  
Vlera 43.300.000 ( *dyzet e tre milion e treqind mije* ) leke
3. *Emri i plotë i shoqërisë* ALKO IMPEX General Construction dege e shoqerise se huaj ,  
*numri i NIPT-it* K91326028I  
Vlera 48.230.041 ( *dyzet e tete milion e dyqind e tridhjetë mije e dyzet e nje* ) leke
4. *Emri i plotë i shoqërisë* JUBICA shpk , *numri i NIPT-it* K26529001I  
Vlera 47.500.000 ( *dyzet e shtate milion e peseqind e mije* ) leke
5. *Emri i plotë i shoqërisë* STERKAJ shpk , *numri i NIPT-it* J68310708M  
Vlera 41.370.044 ( *dyzet e nje milion e treqind e shtatedhjetë mije e dyzet e kater* ) leke
6. *Emri i plotë i shoqërisë* CURRI shpk , *numri i NIPT-it* J 67902718S  
Vlera 52.305.071 ( *pesedhjetë e dy milion e treqind e pese mije e shtatedhjetë e nje* ) leke
7. *Emri i plotë i shoqërisë* GJOKA KONSTRUKSION sha , *numri i NIPT-it* J91805014U  
Vlera 44.630.080 ( *dyzet e kater milion e gjashteqind e tridhjetë mije e tetedhjetë* ) leke
8. *Emri i plotë i shoqërisë* ADEM POJANI , *numri i NIPT-it* nuk ka paraqitur dokument  
Vlera nuk ka paraqitur oferte

Janë skualifikuar ofertuesit e mëposhtëm:

1. *Emri i plotë i shoqërisë* STERKAJ shpk , *numri i NIPT-it* J68310708M
2. *Emri i plotë i shoqërisë* CURRI shpk , *numri i NIPT-it* J 67902718S
3. *Emri i plotë i shoqërisë* JUBICA shpk , *numri i NIPT-it* K26529001I
4. *Emri i plotë i shoqërisë* GJOKA KONSTRUKSION sha , *numri i NIPT-it* J91805014U
5. *Emri i plotë i shoqërisë* ADEM POJANI , *numri i NIPT-it* nuk ka paraqitur dokument

Përkatësisht për arsyet e mëposhtme:

#### 1. Operatori : STERKAJ shpk

Rezulton se nuk ploteson kriteret e vendosura sipas dst si më poshtë:

Ne licencen e shoqërisë Sterkaj me Licence NZ.1354/18 evidentohen drejtuesit teknik : Blerina Hoxha, **Rexhina Hysko**, Gentian Kallfa, **Adrian Frroku**, Roza Karaduni, Ismail Pervana, Emanuela Kiri, Leodet Kiri .

#### Licenca e shoqërisë mban datën 13.03.2017.

**Nga verifikimi i listpagesave janar , shkurt , mars, prill 2018 ,** rezulton se nuk janë derdhur kontribute për sigurime shoqërore për drejtuesit teknik ; **Rexhina Hysko dhe Adrian Frroku.** *Kjo në kundërshtim me nenin 45 pika 2/d të LPP ku përcaktohet se . Çdo kandidat ose ofertues skualifikohet nga pjesëmarrja në një procedurë , në rastet kur: a) ka falimentuar dhe kapitalet e tij janë në proces ekzekutimi nga përmbaruesit; b) është subjekt i procedurave për deklarimin e falimentimit dhe ka një urdhër likuidimi të detyruar ose administrimi nga gjykata, ose ka një marrëveshje me kreditorët, ose ndonjë procedurë tjetër të ngjashme; c) është dënuar me vendim gjykatë të formës së prerë për vepra që lidhen me veprimtarinë profesionale; d) nuk i ka përmbushur detyrimet për derdhjen e kontributeve të sigurimeve shoqërore, në përputhje me legjislacionin shqiptar ose me dispozitat e zbatueshme në shtetin e origjinës; dh) nuk i ka përmbushur detyrimet për pagimin e tatimeve, në përputhje me legjislacionin shqiptar ose me dispozitat e zbatueshme në shtetin e origjinës; e) është fajtor për dhënie të informacioneve të rreme, kur këto i janë kërkuar në përputhje me këtë kre, ose nuk ka pranuar t'i japë këto informacione ose dokumente apo një pjesë të tyre. ë) me vendim të Agjencisë së Prokurimit Publik është përjashtuar nga pjesëmarrja në procedurat e prokurimit, sipas pikës 3, të nenit 13, të këtij ligji.*

#### 2. Operatori : CURRI shpk

Rezulton se nuk ploteson kriteret e vendosura sipas dst si më poshtë:

OE “CURRI” shpk u konstatuan **ndërrhyrje** në preventivin e ofertes. Ne preventivin përmbledhës të kontrates, në zërin me indeks 2.13 dhe 2.14, **Komuna e Parisit - Rruga e Kavajës (Loti 1)** dhe **Rruga e Kavajës (Loti 1) - Komuna e Parisit** kohëzgjatja e kontrates ishte **14 muaj** sipas dokumentave të tenderit dhe **jo 24 muaj** sipas ofertuesit. Bazuar në nenin 53 të Ligjit “Për prokurimin publik”, Nr. 9643, datë 20.11.2006, i ndryshuar, pika 5, gërma c, oferta refuzohet.

Shoqëria Curri shp.k në përmbushje të kriterit teknik , Mjete për vendosje parrakesh metalik (guardrails) ( Batipal ) dhe Mjet për vijezim me boje ka paraqitur , Kontratë Qeraje Nr. 164 Rep, Nr. 40 Kol datë 29.06.2018, para noterit publik , lidhur ndërmjet palëve Shoqëria Omega Service

sh.p.k në cilësinë e qeradhënësit dhe Shoqërisë Curri sh.p.k në cilësinë e qeramarrësit me objekt mjetet: **Batipal i perdorur**, vit 1997, model 61, numer serie MCSB008, vertetuar pronesine me deklaraten doganore Nr. R 26138 date 16.05.2011 leshuar nga Dogana Tirane..... dhe **Makine per vijeimin e rrugeve**, vertetuar pronesine me deklaraten doganore Nr. R 7534 date 09.02.2015, leshuar nga Dogana Tirane....., me afat 3 vjet nga lidhja e kontrates .

Gjithashtu në nje procedurë tjetër prokurimi qe zhvillohet ne te njejten date 09.07.2018 , me te njejtin autoritet kontraktor , njëri nga operatorët ekonomikë pjesmarrës Blerimi sh.p.k ne permbushje te kriterit teknik , Mjete per vendosje parrakesh metalik (guardrails) ( Batipal ) dhe Mjet per vijezim me boje ka paraqitur ka paraqitur Kontratë Qeraje Nr. 3035 Rep, Nr. 1116 Kol datë 02.07.2018, para noterit publik , lidhur ndërmjet palëve Shoqëria Omega Service sh.p.k në cilësinë e qeradhënësit dhe Shoqërisë Blerimi sh.p.k në cilësinë e qeramarrësit me objekt mjetet: **Batipal i perdorur**, vit 1997 ,vertetuar pronesine me deklaraten doganore Nr. R 26138 date 16.05.2011 leshuar nga Dogana Tirane..... dhe **Makine per vijeimin e rrugeve** , vertetuar pronesine me deklaraten doganore Nr. R 7534 date 09.02.2015, leshuar nga Dogana Tirane..... , me afat nga lidhja e kontrates deri 31.12.2020.

Komisioni i Vleresimit te Ofertave , gjykon se i gjendur përballë të njëjtës kontratë qeraje që kalon të drejtën e disponueshmërisë së të njëjtesve mjete, **Batipal i perdorur**, vit 1997, model 61, numer serie MCSB008, vertetuar pronesine me deklaraten doganore Nr. R 26138 date 16.05.2011 leshuar nga Dogana Tirane..... dhe **Makine per vijeimin e rrugeve** , vertetuar pronesine me deklaraten doganore Nr. R 7534 date 09.02.2015, leshuar nga Dogana Tirane....., dy operatorëve të ndryshëm ekonomikë, ka vendosur skualifikimin e tyre nga procedurat e prokurimit. Autoriteti kontraktor gjendet përballë një dyshimi real i cili nuk e lejon të krijojë tërësisht bindjen dhe besueshmërinë kundrejt operatorëve ekonomikë duke mos njohur realisht se cilit nga operatorët ekonomikë i përket vërtet disponueshmëria faktike përtej asaj ligjore e mjetit. Akoma më tej Komisioni i Vleresimit te Ofertave, gjykon se zgjidhja e një konflikti hipotetikusht të mundshëm, midis operatorëve ekonomikë në lidhje me të drejtën e disponueshmërisë së mjeteve te mesiperme , mund të jetë objekt zgjidhjeje nga organe të tjera kompetente të ngarkuara nga ligji, por kursesi nga autoriteti kontraktor në momentin e zhvillimit të procedurës së prokurimit. Ky i fundit nuk e ka tagrin dhe mundësinë për tu shprehur përtej anës formale mbi vlefshmërinë e kontratave respektive të qerasë të cilat janë lidhur rregullisht përpara noterit publik. Në vijim të këtij arsytimi Komisioni i Vleresimit te Ofertave gjykon se anjë prej operatorëve ekonomik nuk ka bindur tërësisht autoritetin kontraktor lidhur me plotësimin e kapaciteteve teknike : Mjete per vendosje parrakesh metalik (guardrails) ( Batipal ) dhe Mjet per vijezim me boje.

### 3. Operatori : JUBICA shpk

Rezulton se nuk ploteson kriteret e vendosura sipas dst si më poshtë:

#### **Rezulton se dokumentet nuk jane paraqitur ne perputhje me kerkesat e kerkuara :**

Ne licencen e shoqerise JUBICA me Licence NZ.0340/16 evidentohen drejtuesit teknik :

**Gjon Tarri**, Elvis Capo, Myzafer Lesha, Enkel Tasho, Arber Shehu.

**Licenca e shoqerise mban daten 11.05.2017.**

**Nga verifikimi i listpagesave janar ,shkurt ,mars, prill 2018 , rezulton se nuk jane derdhur kontribute per sigurime shoqerore , per drejtuesin teknik ; Gjon Tarri.**

*Kjo ne kundërshtim me nenin 45 pika 2/d te LPP ku percaktohet se . Çdo kandidat ose ofertues skualifikohet nga pjesëmarrja në një procedurë , në rastet kur: a) ka falimentuar dhe kapitalet e tij janë në proces ekzekutimi nga përmbaruesit; b) është subjekt i procedurave për deklarimin e falimentimit dhe ka një urdhër likuidimi të detyruar ose administrimi nga gjykata, ose ka një marrëveshje me kreditorët, ose ndonjë procedurë tjetër të ngjashme; c) është dënuar me vendim gjykatë të formës së prerë për vepra që lidhen me veprimtarinë profesionale; d) nuk i ka përmbushur detyrimet për derdhjen e kontributeve të sigurimeve shoqërore, në përputhje me legjislacionin shqiptar ose me dispozitat e zbatueshme në shtetin e origjinës; dh) nuk i ka përmbushur detyrimet për pagimin e tatimeve, në përputhje me legjislacionin shqiptar ose me dispozitat e zbatueshme në shtetin e origjinës; e) është fajtor për dhënie të informacioneve të rreme, kur këto i janë kërkuar në përputhje me këtë kre, ose nuk ka pranuar t'i japë këto informacione ose dokumente apo një pjesë të tyre. ë) me vendim të Agjencisë së Prokurimit Publik është përjashtuar nga pjesëmarrja në procedurat e prokurimit, sipas pikës 3, të nenit 13, të këtij ligji.*

#### 4. Operatori : GJOKA Konstruksion shpk

Rezulton se nuk plotëson kriteret e vendosura sipas dst si më poshtë:

Shoqëria Gjoka Konstruksion sh.a ne përmbushje te kriterit teknik, Automjet borepastrues (APV) ose agregatë per pastrimin e bores dhe shperndares kripe me kamion ne dispozicion dhe Mjet per vijezim me boje ka paraqitur , Kontratë Qeraje Nr. 71 datë 06.07.2018, lidhur ndërmjet palëve, Shoqëria SELAMI sh.p.k në cilësinë e qeradhënësit dhe Shoqërisë Gjoka Konstruksion sh.a në cilësinë e qeramarrësit me objekt mjetet: **Makinë për shenjëzimin e vijave në rrugë**, vertetuar pronesine me deklaraten doganore Nr. R 505 date 22.06.2016 leshuar nga Dogana Bllate..... si dhe 2 automjete **Borëpastruese me targë AA265FA dhe targë AA996MU** , vertetuar pronesine me lejet e qarkullimit respektive.

Gjithashtu në një procedurë tjetër prokurimi që zhvillohet në të njëjtën datë 09.07.2018 , me të njëjtin autoritet kontraktor, njëri nga operatorët ekonomikë pjesëmarrës SELAMI sh.p.k (qeradhënësi) ne përmbushje te kriterit teknik ka paraqitur, **Makinë për shenjëzimin e vijave në rrugë**, vertetuar pronesine me deklaraten doganore Nr. R 505 date 22.06.2016 leshuar nga Dogana Bllate..... si dhe 2 automjete **Borëpastruese me targë AA265FA dhe targë AA996MU** , vertetuar pronesine me lejet e qarkullimit respektive.

Komisioni i Vleresimit te Ofertave , gjykon se i gjendur përballë një kontrate qeraje që kalon të drejtën e disponueshmërisë së të njëjtave mjete, **Makinë për shenjëzimin e vijave në rrugë**, vertetuar pronesine me deklaraten doganore Nr. R 505 date 22.06.2016 leshuar nga Dogana Bllate..... si dhe 2 automjete **Borëpastruese me targë AA265FA dhe targë AA996MU**, vertetuar pronesine me lejet e qarkullimit respektive....., si dhe faktit që qeradhënësi SELAMI shpk i kaparaqitur po këto mjete në pronësi të vetën, ka vendosur skualifikimin e tyre nga procedurat e prokurimit. Autoriteti kontraktor gjendet përballë një dyshimi real i cili nuk e lejon të krijojë tërësisht bindjen dhe besueshmërinë kundrejt operatorëve ekonomikë duke mos njohur realisht se cilit nga operatorët ekonomikë i përket vërtet disponueshmëria faktike përtej asaj ligjore e mjetit. Akoma më tej Komisioni i Vleresimit te Ofertave, gjykon se zgjidhja e një konflikti hipotetikisht të mundshëm, midis operatorëve ekonomikë në lidhje me të drejtën e disponueshmërisë së mjeteve të mesiperme , mund të jetë objekt zgjidhjeje nga organe të tjera kompetente të ngarkuara nga ligji, por kursesi nga autoriteti kontraktor në momentin e zhvillimit të procedurës së prokurimit. Ky i

fundit nuk e ka tagrin dhe mundësinë për tu shprehur përtej anës formale mbi vlefshmërinë e kontratës së qerasë. Në vijim të këtij arsyetimi Komisioni i Vleresimit të Ofertave gjykon se anjë prej operatorëve ekonomik nuk ka bindur tërësisht autoritetin kontraktor lidhur me plotësimin e kapaciteteve teknikë : **Makinë për shenjzimin e vijave në rrugë**, vertetuar pronësine me deklaratën doganore Nr. R 505 date 22.06.2016 leshuar nga Dogana Bllate..... si dhe 2 automjete **Borëpastruese me targë AA265FA dhe targë AA996MU** , vertetuar pronësine me lejet e qarkullimit respektive.

## 5. Operatori : Adem Pojani

Rezulton se nuk ka paraqitur asnjë dokument.

\* \* \*

Duke iu referuar procedurës së lartpërmendur, informojmë , “ NIKA “ shpk, numri i NIPT-it J 76705047 U , me adrese : Lagjja Vasil Shanto ,Bulevardi Skenderbeu , godinë 8 kateshe , kati i I-re, Nr.Pasurie 1014/3, Zona Kadastrale 8593,nr.pasurie 5/587 , Shkoder , se oferta e paraqitur, me një vlerë të përgjithshme prej 34.543.340 ( tridhjetë e kater milion e peseqind e dyzet e tre mije e treqind e dyzet ) leke /pikët totale të marra [ \_\_\_\_\_]është identifikuar si oferta e suksesshme.

Rrjedhimisht, jeni i lutur të paraqisni pranë , *Drejtoria e Rajonit Qendror Tirane me adrese ,Rr . Princ Vidi , nr.18/3 , Tirane* , sigurimin e kontratës, siç parashikohet në dokumentat e tenderit, brenda 5 ditëve nga dita e marrjes/publikimit të këtij njoftimi.

Në rast se nuk pajtoheni me këtë kërkesë, ose tërhiqeni nga nënshkrimi i kontratës, do të konfiskohet sigurimi i ofertës suaj (nëse është kërkuar) dhe kontrata do t’i akordohet ofertuesit vijues në klasifikimin përfundimtar, oferta e të cilit është dorëzuar me një vlerë të përgjithshme prej 43.300.000 ( dyzet e tre milion e treqind mije ) leke , siç parashikohet në nenin 58 të Ligjit nr.9643 datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar.

Njoftimi i Klasifikimit është bërë në datë 26.07.2018 .

Ankesa: Nika shpk dhe Sterkaj shpk.

(nëse ka) ka marrë përgjigje në datë : Vendimi i Komisionit të Prokurimit Publik , me numër 733/3/2018 , datë 15.11.2018 , në pikën 1, ka vendosur “ *Të heqë pezullimin për procedurën e prokurimit “Procedurë e Hapur” me Nr.REF-73352-06-05-2018 me objekt Mirëmbajtje me performancë Ura e Brarit - Tunel Qafë Murrizë (Rruga e Arbrit), K/Rr. Nr. 54 (Trau Dajt) - Deg. dj. maja e Dajtit, Deg. dj. maja e Dajtit - St. teleferikut, Deg. dj. maja e Dajtit - Vila Qeveritare, Vila Qeveritare - maja e Dajtit, Tiranë (Fresku) - Surrel, Surrel - Qafë Priskë, Qafë Priskë - deg. dj. Q. Mollë,deg. dj. Q. Mollë - Bizë , Qafë Priskë - Shkallë - Shëngjergj, Uzina Traktorit - Lanabregas, Farkë – Rruga Elbasanit (Sauk) - Komuna e Parisit - Rruga e Kavajës (Loti 1) (104.13 km) (Kontrata 2), me fond limit 54.520.654 leke pa TVSH, zhvilluar në datë 09.07.2018 nga autoriteti kontraktor, Drejtoria e Rajonit Qendror Tiranë.”*